

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PROXIMA CONSULTING” SH.P.K.

Sot, më datë 11/08.2022

Z.Lorenc Dhimgjini, atesia Vasil, amesia Enrjeta, i dl.01/03/1980, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, lagjia Nr.12, me zotesi te plote per te vepruar, i pajisur me Karte identiteti me ID 038207442 dhe Nr.personal I00301069V.

Ka vendosur krijimin e Shoqërisë tregtare “PROXIMA CONSULTING” SH.P.K., me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare “PROXIMA CONSULTING” SH.P.K., themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë Shoqëria).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “PROXIMA CONSULTING” SH.P.K. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është:

Ofrimi i shërbimeve të asistencës dhe konsulencës të biznesit, ligjore, kontraktuale, ekonomike, administrative, financiare, biznesore, menaxheriale, dhe të drejtimit për sipërmarrjet, profesionistët, entet private dhe publike, entet lokale dhe të tretët në përgjithësi. Shërbime marketing, komunikim, dhe marrëdhënie me publikun në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Zhvillimi i shërbimeve të konsulencës në fushën e teknologjisë së informacionit, të networkut dhe gjithçkaje që ka të bëjë me botën e informatikës dhe internetit; për këtë qëllim shoqëria mund të procedojë me ofrimin e aksesit në internet, me ofrimin e shërbimeve të housing e hosting, intranet, extranet, community, zhvillim software dhe aplikime multimediale.

Realizimin dhe mirëmbajtjen e faqeve web, realizimin dhe regjistrimin e domeineve, mbledhjen, ndërmjetësimin, shitjen dhe publikimin e hapësirave publicitare on-line (banneri), realizimin e shërbimeve të grafikes publicitare dhe, në përgjithësi, të gjithçkaje që ka lidhje me kurimin e koordinuar të imazhit nga sipërmarrjet.

Marrje koncensionesh, mandate agjensie, perfaqesimi dhe promovimi per aktivite marketingu, publicitare, kerkime tregu dhe sherbime;

Ideim, projektim, krijim, marketing, instalim, asistence teknike dhe menaxhim baze te dhenash, sistemesh informative dhe komunikimi te cdo lloji, si edhe te sistemeve elektronike, qe realizohen me ane te perdorimit te kompjuterit, software-ve dhe mjeteve te tjera teknologjike te cdo natyre ose funksioni, si edhe marjen e dhenien e licensave, patentave, know-how dhe perfaqesimeve qe kane te bejne me to.

Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te cdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohe me ligj.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Shoqeria ka seline ligjore:

Durres, Lagjia Nr.12, Rruga "Mozaikeve", Godina Nr.6/500/ND+1-6 dhe ZK: 8513 Durres

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi ne te gjithë territorin shqiptar dhe jashte tij.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut themelues të kësaj Shoqërie. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Leke dhe përbëhet nga 1 (nje) kuote.

1) Z.Lorenc Dhimgjini është zoterues i 1 kuote me 100% pjesemarje ne kapitalin e shoqerise ne vleren 100.000(njeqindmije) leke.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet për një afat 5 vjecar, me te drejte rimerimi. Administatori i Shoqërisë do të jetë **Z. Lorenc Dhimgjini**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrorë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 10

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduken Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11**Legjislacioni i aplikuar**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët e Shoqërisë . Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

ORTAKU THEMELUES**Lorenc DHIMGJINI**

DHIMGJINI LORENC
